



KOLEGJI - COLLEGE
BIZNESI
Prishtinë

www.kolegjibiznesi.com | info@kolegjibiznesi.com

038 500 878 | 044 500 878 | 049 500 878

Prishtinë, Ulpianë, rr. "Motrat Qiriaz" nr. 29

PLANPROGRAMI MËSIMOR – SYLLABUS							
Niveli i studimeve		Bachelor	Programi	Menaxhment		Viti Akademik	2020-21
Lënda		MIKROEKONOMIA I					
Viti	I	Statusi i lëndës	Obligative	ECTS/kredi		7	
Semestri	I						
Javët mësimore		15		Orët mësimore	Ligjërata	Ushtrime	
					3	2	
Metoda e mësimi		Ligjërata, ushtrime, punime, konsultime, teste, raste studimi, detyra, ushtrime, etj.					
Konsultime		Dy orë pas ligjëratave					
Mësimdhënësi		Dr.sc.Ariana Xhemajli		Tel/mob	(049) 363-333		
				e-mail	arianaxhemajli@gmail.com		
Asistenti				Tel/mob			
				e-mail			
Qëllimi studimor dhe përmbajtja e lëndës				Përfitimet e Studentit			
Përmbajtja. Nga kjo lëndë studentët do të marrin njohuri të përgjithshme për shkencat ekonomike, kurse në veçanti për faktorët e prodhimit, si dhe për kufirin e mundësive të prodhimit (KMP) dhe shpenzimet oportune. Me programin e kësaj lënde, studentët do të mësojnë për nocionin e mikroekonomisë, ndërmarrjes, si dhe format e ndërmarrjes në ekonominë e tregut, duke përfshirë resurset e ndërmarrjes, analizën e shpenzimeve, kapacitetet dhe llojet e tyre dhe amortizimin. Nga kjo lëndë, studentët do të fitojnë njohuri profesionale për kuptimin dhe funksionimin e tregut, kërkesën, ofertën dhe ekuilibrit të tregut, madje elasticitetin e ofertës dhe të kërkesës, si postulate kryesore të ekonomisë së tregut, në nivel të subjekteve ekonomike. Madje, nga programi i kësaj lënde studentëve u ofrohet njohuri për kërkesën dhe sjelljen e konsumatorit, duke përfshirë: dobinë marginale, ekuilibrin e konsumatorit, lakoren e				Qëllimi. Qëllimi kryesor i kësaj lënde ekonomike, është që studentët të fitojnë njohuri të përgjithshme dhe bazike (fillestare) nga mikroekonomia. Kjo lëndë përfshinë njohurit bazike të kategorive mikroekonomike, e cila më pastaj do t'iu shërbejë studentëve për përvetësimin më lehtë dhe zgjerimin e njohurive makro-ekonomike. Ndonëse, me këtë rast studentët njoftohen dhe marrin njohuri për terminologjinë dhe kategoritë kryesore ekonomike, gjithnjë duke mbetur në nivel të subjekteve ekonomike. Madje, qëllimi i kësaj lëndë është që t'i inkurajojë studentët për të hyrë në probleme profesionale ekonomike, të fitojnë njohuri të mjaftueshme për t'u futur në dialog konstruktiv dhe të hapur për problemet ekonomike, qofshin ato teorike apo praktike. Me formën interaktive, studentët zgjerojnë dhe plotësojnë njohurit e tyre nga fusha e mikroekonomisë, si dhe			

indiferencës dhe hartën e lakoresë së indiferencës. Nga programi i kësaj lënde, studentët në veçanti përfitojnë njohuri të duhur profesionale për sjelljen e subjekteve ekonomike në tregjet konkurrionale, ku përfshihet konkurrenca e plotë, oferta e ndërmarrjes dhe e degës në tregun konkurrional dhe efikasiteti në konkurrencë të plotë dhe tregjet jokonkurrionale, duke përfshirë monopolin dhe llojet e tij, të ardhurat margjinale dhe monopoli, diskriminimin e çmimev, oligopolin dhe teorinë e lojës. Pjesë të rëndësishme të programit të kësaj lënde paraqet nocioni dhe shpërndarja e të ardhurave, paga dhe tregu i punës, diskriminimi në punë, ndikimi i sindikatave në ruajtjen e të drejtave të punëtorëve dhe si asociacion partneriteti me Qeverinë, toka dhe renta dhe kapitali, kamata (interesi) dhe profiti. Me programin e kësaj lënde, studentët marrin njohuri për ndikimin e shtetit në ekonominë, përkatësisht për intervenimin e tij në ekonomi nëpërmjet instrumenteve të politikës fiskale, me të cilat shteti krijon mjetet buxhetore, të politikës kreditore etj., si instrumente me rëndësi të politikës së zbatuar ekonomike. Studentët gjatë ushtrimeve do të kenë rastin që t'i përforcojnë edhe më tepër qasjet teorike të problemeve dhe kategorive ekonomike me zbatimin e tyre në jetën praktike. Nga ata do të kërkohet që të jenë interaktiv, duke kërkuar lidhshmërinë, funksionimin dhe veprimin praktikë të kategorive të caktuara ekonomike. Andaj, ushtrimet do të shërbejnë si formë ku teoria lidhet me praktikën, me ç'rast studentët aftësohen që të mos kenë probleme me rastin e startimit në punë. Nga ky aspekt mund të thuhet se, ushtrimet kanë rëndësi të madhe për aftësimin e studentëve që njohuritë teorike t'i zbatojnë pa vështirësi në jetën praktikë.

evitojnë paqartësitë eventuale nga kjo fushë ekonomike. Kuptohet, qëllimi i fundit është që studentët të përvetësojnë materien e kësaj lënde, të bëhen të shkathët për zgjidhjen e problemeve ekonomike, sepse vetëm në këtë bazë të ngritjes profesionale, ata do të aftësohen për të kryer misionin e tyre profesional të profilit të ekonomistit.

Rezultatet e pritura. Me përvetësimin e kësaj lënde, studentët aftësohen:

- Ti kuptojnë drejtë nocionin dhe kategorit mikroekonomike,
- Të marrin njohuri dhe të aftësohen në pikëpamje profesionale nga mikroekonomia dhe që ato t'i zbatojnë në jetën praktike,
- Ta kuptojnë drejtë veprimin e ligjeve ekonomike, veçmas ligjin e vlerës dhe ndikimin e tyre në rrjedhat ekonomike,
- Të aftësohen profesionalisht për menaxhimin, hartimin e planeve dhe strategjive zhvillimore në nivel të subjekteve ekonomike dhe të ekonomisë në tërësi,
- Të bëhen ekspert të rinjë në fushën mikroekonomike, ku do të ndihmojnë për krijimin e vizionit real dhe objektiv të afarizmit mikroekonomik, duke krijuar koncepte dhe strategji reale për zhvillimin e ekonomisë së Kosovës në përgjithësi.
- Të bëhen profesionalisht të përgatitët për shtruarjen dhe zgjidhjen e problemeve ekonomike.

METODOLOGJIA PËR REALIZIMIN E TEMAVE MËSIMORE

Gjatë punës me studentë do të zbatohen këto metoda dhe forma të punës (ligjërimit):

1. **Metoda e ligjërimit**, e cila realizohet kryesisht përmes projektorit, ku gjatë ligjërimit të pedagogut, në mënyrë vizuale studentët përciellin ligjeratat. Kjo metodë është treguar efikase, sepse studentët i vënë në pozicion aktiv në përcielljen e ligjeratave.
2. **Metoda e ushtrimeve**, ku studentët janë të ndarë në grupe dhe marrin pjesë interaktive për materien e kaluar të lëndës nga ligjeratat, si dhe përmes punëve seminarike. Punimin seminarik e

përgatit një apo grup studentës nga materia e lëndës së mikroekonomisë, dhe lidhur me temën përkatëse zhvillohet debat profesional.

KUSHTET PËR REALIZIMIN E TEMËS MËSIMORE

Ligjeratat mbahen në grupe dhe varësisht nga numri i studentëve caktohet dhe madhësia e sallës, apo amfiteatri. Sallat janë të pajisuar me oriendi adekuate (banka dhe karriga) dhe me pajisje teknike (projektor dhe shtëpiza të kompjuterit), të cilat janë të mjaftueshme për mbajtjen e ligjëratave nga lëndë teorike, siç është edhe mikroekonomia.

Mënyra e vlerësimit të studentit (në %):

	Vlerësimi në %	Nota përfundimtare
Prezantimi dhe puna grupore: 0-5 %	91-100	10 (dhjetë)
Prezantim Individual: 0-5 %	81-90	9 (nëntë)
Aktiviteti: 0-10 %	71-80	8 (tetë)
Punim seminarik: 0-10 %	61-70	7 (shtatë)
Testi i I: 0-15 %	51-60	6 (gjashtë)
Testi i II: 0-15 %		
Provim përfundimtar: 0-40%		

OBLIGIMET E STUDENTIT

Ligjërata	Ushtrime
- Vijimi i Ligjëratave - Pjesëmarrje aktive, - Punime seminarike, projekte, - Pjesëmarrje ne teste dhe ushtrime, - Provim përfundimtar.	- Pjesëmarrje ne ushtrime - Puna individuale dhe grupe ne raste studimi, - Pjesëmarrje diskutime.

NGARKESA E STUDENTIT PËR LËNDËN

Aktiviteti	Orë	Ditë/Javë	Gjithsejtë
Ligjërata	2	15	30
Ushtrime	2	15	30
Punë Praktike	1	15	15
Kontakte me mësimdhënësin	1	10	10
Ushtrime në teren	-	-	-
Kolekfiume/seminare	2	5	10
Detyra të shtëpisë	-	-	-
Koha e studimit vetanak	2	15	30
Përgatitja përfundimtare për provim	2	15	30
Koha e kaluar ne vlerësime (teste, kuiz, provimi final)	2	10	20
Projektet propozimet	2	5	10
Vërejtje: 1 ECTS kredi = 30 orë angazhim, p.sh. nëse lënda i ka 6 ECTS kredi studentit duhet të ketë angazhim gjatë semestrit 180 orë		Ngarkesa totale:	180

Java	Ligjërata		Ushtrime	
	Tema	Orët	Tema	Orët

1	Java e parë- EKONOMIKSI DHE ARSYETIMI EKONOMIK Libri: “Mikroekonomi ”, I. Tabaku. E. Nesturi, E. Pazaj. 2015, Tirane	3	EKONOMIKSI DHE ARSYETIMI EKONOMIK Libri: “Mikroekonomi ”, I. Tabaku. E. Nesturi, E. Pazaj. 2015, Tirane	2
2	Java e dytë- ORGANIZIMI EKONOMIK I SHOQËRISË Libri: “Mikroekonomi ”, I. Tabaku. E. Nesturi, E. Pazaj. 2015, Tirane	3	ORGANIZIMI EKONOMIK I SHOQËRISË Libri: “Mikroekonomi ”, I. Tabaku. E. Nesturi, E. Pazaj. 2015, Tirane	2
3	Java e tretë- NDËRVARËSIA DHE PËRFITIMET NGA TREGU. Libri: “Mikroekonomi ”, I. Tabaku. E. Nesturi, E. Pazaj. 2015, Tirane	3	NDËRVARËSIA DHE PËRFITIMET NGA TREGU. Libri: “Mikroekonomi ”, I. Tabaku. E. Nesturi, E. Pazaj. 2015, Tirane	2
4	Java e katërtë- KERKESA OFERTA DHE ELASTICITETET Libri: “Mikroekonomi ”, I. Tabaku. E. Nesturi, E. Pazaj. 2015, Tirane	3	KERKESA OFERTA DHE ELASTICITETET Libri: “Mikroekonomi ”, I. Tabaku. E. Nesturi, E. Pazaj. 2015, Tirane	2
5	Java e pestë- TAKSAT DHE NDËRHYRJA E QEVERISË Libri: “Mikroekonomi ”, I. Tabaku. E. Nesturi, E. Pazaj. 2015, Tirane	3	TAKSAT DHE NDËRHYRJA E QEVERISË Libri: “Mikroekonomi ”, I. Tabaku. E. Nesturi, E. Pazaj. 2015, Tirane	2
6	Java e gjashtë- APLIKIME TE TREGUT NDERKOMBETAR Libri: “Mikroekonomi ”, I. Tabaku. E. Nesturi, E. Pazaj. 2015, Tirane	3	APLIKIME TE TREGUT NDERKOMBETAR Libri: “Mikroekonomi ”, I. Tabaku. E. Nesturi, E. Pazaj. 2015, Tirane	2
7	Kollokvumi i parë	3	Kolokviumi parë	2
8	Java e tetë- LOGJIKA E ZGJEDHJEVE INDIVIDUALE Libri: “Mikroekonomi ”, I. Tabaku. E. Nesturi, E. Pazaj. 2015, Tirane	3	LOGJIKA E ZGJEDHJEVE INDIVIDUALE Libri: “Mikroekonomi ”, I. Tabaku. E. Nesturi, E. Pazaj. 2015, Tirane	2
9	Java e nëntë- PRODHIMI DHE ANALIZA E KOSTOVE I Libri: “Mikroekonomi ”, I. Tabaku. E. Nesturi, E. Pazaj. 2015, Tirane	3	PRODHIMI DHE ANALIZA E KOSTOVE I Libri: “Mikroekonomi ”, I. Tabaku. E. Nesturi, E. Pazaj. 2015, Tirane	2
10	Java e dhjetë- PRODHIMI DHE ANALIZA E KOSTOVE II Libri: “Mikroekonomi ”, I. Tabaku. E. Nesturi, E. Pazaj. 2015, Tirane	3	PRODHIMI DHE ANALIZA E KOSTOVE II Libri: “Mikroekonomi ”, I. Tabaku. E. Nesturi, E. Pazaj. 2015, Tirane	2
11	Java e njëmbdhjetë- KONKURRENCA PERFEKTE Libri: “Mikroekonomi ”, I. Tabaku. E. Nesturi, E. Pazaj. 2015, Tirane	3	KONKURRENCA PERFEKTE Libri: “Mikroekonomi ”, I. Tabaku. E. Nesturi, E. Pazaj. 2015, Tirane	2

12	Java e dymbdhjetë- MONOPOLI Libri: “Mikroekonomi ”, I. Tabaku. E. Nesturi, E. Pazaj. 2015, Tirane	3	MONOPOLI Libri: “Mikroekonomi ”, I. Tabaku. E. Nesturi, E. Pazaj. 2015, Tirane	2
13	Kolokviumi i dytë	3	Kolokviumi i dytë	2
14	Java e katërmbdhjetë- KONKURRENCA MONOPOLISTIKE, OLIGOPOLI DHE STRATEGJIA E VENDOSJES SË ÇMIMIT Libri: “Mikroekonomi ”, I. Tabaku. E. Nesturi, E. Pazaj. 2015, Tirane	3	KONKURRENCA MONOPOLISTIKE, OLIGOPOLI DHE STRATEGJIA E VENDOSJES SË ÇMIMIT Libri: “Mikroekonomi ”, I. Tabaku. E. Nesturi, E. Pazaj. 2015, Tirane	2
15	Java e pesëmbdhjetë- TREGJET E FAKTOREVE TE PRODHIMIT Libri: “Mikroekonomi ”, I. Tabaku. E. Nesturi, E. Pazaj. 2015, Tirane	3	TREGJET E FAKTOREVE TE PRODHIMIT Libri: “Mikroekonomi ”, I. Tabaku. E. Nesturi, E. Pazaj. 2015, Tirane	2

LITERATURA

Literatura bazë:

1. Prof. As. Irma Tabaku, Dr. Eglantin Pazaj, Msc.Erdit Nesturi , Mikroekonomia, Tiranë, 2015.

Literatura shitesë:

1. Hal R. Varian, Mikroekonomia, shtepia botuese Onufri, Tiranë, 2000.
2. Dr. Sulo Hadëri, Mikroekonomia, Tiranë, 2012
3. Kristen Ahlersten, Microeconomics, 2008.
4. Hal R. Varian, Universiteti i Michiganit, ed. III. (përkthimi shqip), Onufri, Tiranë, 2000
5. Prof.dr.Musa Limani, Mikroekonomia, Kolegji “BIZNESI”, Prishtinë, 2011.
6. Ahmet Mançellari, Sulo Hadëri, Dhorë Kule, Stefan Qiriçi, Hyrje në ekonomi, Tiranë 2007.
7. Mikroekonomia (Universiteti i Shkodrës) Esmeralda URUÇI, Tiranë, 2004

VËREJTJE

Për çdo temë mësimore, studentët do të pajisen me materiale të nevojshme në gjuhën shqipe. Në fund të çdo ore mësimore, grupet e caktuara të studentëve do të angazhohen me detyrë apo rast studimi lidhur me temën e ligjëruar. *Rezultatet e arritura nga ajo detyrë, grupet e studentëve duhet t'i prezantojnë dhe diskutojnë ato në orën e ushtrimeve.*

VËREJTJE PËR STUDENTIN

- Para së gjithash, studenti duhet të jetë i ndërgjegjshëm dhe të respektojë institucionin dhe rregullat shkollore;
- Duhet të respektojë orarin e ligjëratave, ushtrimeve dhe punimet seminarike, të jetë i vëmendshëm në orën mësimore;
- Është i obliguar posedimi dhe paraqitja e dokumentit identifikues në teste dhe provim;
- Gjatë hartimit të punimeve seminarike, studenti duhet ti përmbahet udhëzimeve të dhëna nga mësimdhënësi për realizimin e hulumtues dhe teknik të punimit;
- Testet dhe provimet vlerësohen individualisht për secilin student. Prandaj, studentet duhet të

- përqendrohen vetëm në njohuritë personale.
- Shkelja eventuale e këtyre parimeve etike (rregullave) ndëshkohet konform normave të parapara me ligj.

Profesori i lëndës:

Prof. Dr. Ariana Xhemajli